REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURES

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 881 Prot.

Tiranë, më 06.07.2018

**VENDIM Nr. 119, datë 27.06.2018**

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 27.06.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër ***të projektit "HEC EME" Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë***-subjekti "EME ENERGY" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër ***të projektit "HEC EME" Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë***-subjekti "EME ENERGY" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

2. Subjekti "EME ENERGY" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC EME" Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.

3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: *sekretaria.kka@asha.gov.al*
Website: asha.gov.al